



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHENDETESISE DHE E MBBROJTJES SOCIALE
QENDRA SHENDETSORE E SPECIALITETEVE NR.1
TIRANE

Nr. ____ Prot

Tirane,me ____01.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekesore” për nevojat e Qendres
Shendetesore te Specialiteteve nr.1 Tirane

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale mjekesore te konsumueshme- 33140000-3

**Fondi limit: 1474160 (nje milion e katerqind e shtatedhete e kater mije e njeqind e
gjashtedhete) leke pa tvsh**

Njesia e Prokurimit pasi u njoh me Urdherin e Prokurimit Nr. 1, date 18.01.2024 filloi nga puna per te hartuar kriteret e pranimit dhe kualifikimit sipas specializimeve perkatese qe ka seicili anetar i njesise se prokurimit. Te tre anetaret e njesise se prokurimit duke u nisur dhe nga specializimet dhe percaktuan kriteret e vecanta te paranimit e kualifikimit ne mbeshtetje te Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Qendra Shendetesore e Specialiteteve nr.1* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e ofertës, Shtojca 1

b. Lista e cmimeve të artikujve, shtojca 2

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 29, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilën parashikohet se : 1. Oferta ekonomike përmban vlerën pa tvsh. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur ofertën ekonomike.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76 të LPP, të VKM nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” si dhe nenin 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në të cilën është përcaktuar se : 1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave , AK pranon si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuar nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve në nenin 82 të LPP-se dhe në këto rregulla”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur sipas nenit 83 të LPP-se në të cilën është shprehur se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Autorizim nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, per “Tregtim me shumice/pakice te pajisjeve mjekesore” mbeshtetur ne nenet 21 dhe 22 te Ligjit nr. 89/2014, date 17.07.2014. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet ne nenet 21 dhe 22 te Ligjit nr. 89/2014, date 17.07.2014 “Tregtim me shumice/pakice te pajisjeve mjekesore”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit per te cilin oferton ose shumes se loteve qe ofetohen. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3(tre) viteve te fundit 2021, 2022,2023 . Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, ne te cilat duhet te rezultojte se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te nje pasnjeshem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale :

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizime te meparshme, te ngjashme te kryera gjate viteve te fundit , në një vlerë jo me te vogel se 40% e vlerës së fondit limit të lotit per te cilin oferton ose shumes se loteve qe ofetohen.

Keto furnizime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

- Kur furnizime të mëparshme të ngjashme jane realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate.
ose
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.1 Operatoriekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015 ose e kuivalent i tij** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtar e akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizajnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.2 Vetedeklarim që në rast se OE shpallet i suksesshem, do të bëjë regjistrimin e materialeve mjekesore për të cilat është shpallur i suksesshem në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekesore pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore, në përputhje me nenin 13 të Ligjit 89/2014 “Për Pajisjet Mjekesore”.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në pikën 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 13 të Ligjit 89/2014 “Për Pajisjet Mjekesore” sipas se ciles: *“Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga: a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë*

të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore”.

2.3.3OE duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi (ku te provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nepermjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet te tregetoje pajisjet objekt i kesaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet te jete origjinal ose kopje e perkthyer dhe e noterizuar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor I autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tijlidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesidhe jo operatoriekonomikofertues(ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese fotografi dhe kataloge teknike te produkteve objekt prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise se paisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST

2.3.5 *Data e skadencës për materialet mjekësore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 12 (dymbëdhjete) muaj, data e levrimin te mallit. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate.*

Argumentimi: Kriteri i vendosur në germën f) dhe g) është vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 36 dhe 77 te

Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”. Deklarata mbi origjinen e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj do të bëhet krahasimi i ofertës, materialeve që ofertojnë nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

2.3.6 Leverimi i mallit do të bëhet brenda 7 (shtate) dite nga data e lidhjes së kontratës. **Per kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje Deklarate per Afatin e Levrimet sipas kerkeses se mesiperme**

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

“Blerje material mjekesore”

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Shiringa 5 ml	cope	40000
2	Shiringa 2 ml	cope	200
3	Cotton (te paketuara 100 gr)	cope	800
4	Doreza *100 S (gome)	kuti	200
5	Doreza *100 M	kuti	500
6	Doreza *100 L	kuti	20
7	Alkol 70 % 1 lt	Litra	150
8	Leter EKG (fletpalosje 3 kanalshe) 80 mm	Cope	100
9	Leter spirometri 110x50	rulo	30
10	Aparat tensioni, cilesore, mos te levize koka	cope	20

11	Xhel per aparatura per eko (ngjyre blu me kokerriza)	Bidon (5 Litra)	100
12	Leter printimi per ECHO (me shkelqim 110 HG)	Rulo	300
13	Alkol salicilik 2%	Litra	20
14	Betadine 1 L	litra	5
15	Garze (91 cm*100m) dendesi 24*20 100% pambuk	metra	100
16	Ankerplast injeksioni (PULLA) *100	kuti	100
17	Maska fytyre *50	kuti	70
18	Spatula druri sterile *100	kuti	1
19	Uje oksigjene *11	litra	5
20	Bende 10cmX 10m 100% pambuk dendesia 24*20	Cope	100
21	Dezinfektant veglash 1L	Litra	23
22	Alkol i bardhe pa ngjyre	Litra	3
23	Alkol 90 %	Litra	10
24	Elektroda	Cope	4000
25	Termometer	Cope	3
26	Gojeza Spirometrie. Gojezat duhet te jene nje perdorimshe. (Jo plastike)	Cope	3000
27	Dezinfektant per ap. Fibroskopise (sekusept), pluhur	Kg	15
28	Shishe Biopsie	cope	50
29	Bisturi 20,21,22	cope	30
30	Zhgut	cope	10
31	Furce per pastrim te aparatit te fibreoskopise	cope	5

Tabela mbaron me numrin rendor 31 (tridhete e nje).

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Afati i Skadences: Data e skadencës për materialet mjekesore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 12 muaj nga data e levrimit të mallit.
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull

Afatet e lëvrimit:

Afati i levrimit të mallit do të jete brenda 7 (shtate) diteve nga data e lidhjes se kontrates. per afatin e levrimit operatori ekonomik duhet te paraqese autodeklarate.

Komisioni i Prokurimit Publik

